



# NË FYTYRAT TONA KA BUZËQESHJE



## NJË DEMOKRACI ME PLOT NGJYRA

DORART (11), ERZA (11), ARBNORA (11), FERIDE (11), MARIGONA (11), SUELA (11), ARLIND (11),  
BLEDAR (11)



**Ne si nxënës të klasës së VI-të, sot kemi ardhur në „Punëtorinë e Demokracisë“ dhe mësuam shumë gjëra. Mësuam se çfarë është demokracia, ku dhe kur është paraqitur për herë të parë, dhe cilat janë elementet e saj. Për më shumë lexoni artikullin tonë**

Në një mëngjes të bukur, rrezonte dielli gjithandej. Athina posa u zgjua dhe shikoi në dritare. Nga jashtë dritares pa shumë njerëz të buzëqeshur. Secili po fliste dhe po jepte mendimin e vet.

Ajo pastroi dhëmbët dhe shkoi poshtë për të ngrënë mëngjes, pasi nëna i kishte përgatitur ushqimin e saj të preferuar. Pasi kishte ngrënë mëngjes, doli në lagje dhe pa se disa nga fqinjët e saj ishin mbledhur. Ata po bisedonin se sa shumë kishte përparuar vendi i tyre, Kosova. Plaku më i vjetër i lagjes po fliste për Kosovën që tashmë ishte bërë shtet demokratik dhe i pavarur. E këtu filloi tema: demokracia. Plaku filloi duke treguar se demokracia për herë të parë është paraqitur në Athinë. „Uau, për herë të parë demokracia qenka paraqitur në Athinë, po ky është edhe emri im!“ - tha e çuditur Athina.

Pastaj foli Driloni, „ne kemi mësuar për demokracinë në lëndën e edukatës qytetare, dhe fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ qeverisje. Pra demokracia do të thotë qeverisje nga populli.“ „Të lumtë more djalë!“ - i tha plaku Drilonit. Pastaj vazhdoi Athina: „Sa bukur është të flasësh bashkë me ju, sepse ju jeni tolerant, gjithmonë flisni për paqe, dhe më e rëndësishmja nuk i dalloni njerëzit nga raca apo gjinia.“ „Unë jam e lumtur që jetoj në këtë lagje. Të jetosh në një vend ku s’ka de-


demokraci është si të jetosh në një shtëpi ku s’ka dritë. Toleranca dhe mirëkuptimi janë elemente që sjellin paqe, tek të gjithë ne.“ përfundoi ajo.



Elementet e demokracisë




„Pëllumbat e Lirisë“




Në shkollë ne marrim dije dhe mësimet tona na ndihmojnë të përparojmë




Qytetarët e përgjegjshëm e dinë rëndësinë e votës. Prandaj, ata votojnë në procesin zgjedhor



Ligjet, rregulla të cilat duhen të respektohen. Vendimet për këto ligje merren në Kuvend



Ne dëshirojmë që vendi ynë të ketë një të ardhme sa më të mirë. Andaj, ne duhet të jemi qytetarë aktiv



Demokracia, fjalë e cila të kujton paqen, tolerancën, lirinë, të drejtat e barabarta, solidaritetin, barazinë, respektin dhe shumë elemente të tjera, të cilat janë shumë të rëndësishme për të gjithë



## INSTITUCIONI LIGJVËNËS

ARBËR (12), ELVIRA (12), ENDRIT (12), ELMEDINA (11), LEON (12), SARA (12), LABINOT (12)

### Detyrat e Kuvendit



#### Kuvendi ndryshe njihet edhe si „Shtëpia e Popullit“

Ne sot kemi folur për institucionin më të lartë të Republikës së Kosovës, i cili quhet Kuvend. Arsyeja pse ne kemi zgjedhur të flasim për institucionin e Kuvendit është sepse jeta jonë është e lidhur jashtëzakonisht shumë me të. E si është e lidhur do t'iu tregojmë në vazhdim. Jemi ne ata të cilët i zgjedhim përfaqësuesit

miratojnë ato me anë të votave. Po ashtu, Kuvendi e zgjedh dhe mund të shkarkojë edhe Presidentin e Qeverinë, meqenëse vetë deputetët e zgjedhin atë. Kuvendi i Kosovës ka shumë detyra. Më të rëndësishmet janë tri, e që ne i quajmë funksione. Ato janë funksioni legjislativ, të cilën e cekëm më lart; funksioni përfaqësues, ku deputetët i përfaqësojnë kërkesat dhe interesat tona; si dhe funksioni kontrollues, ku Kuvendi ushtron kontroll mbi institucionin e Qeverisë. Këtë të fundit e bën duke e monitoruar punën të cilën e bëjnë Kryeministri dhe ministrat, si udhëheqës dhe pjesë e Qeverisë. Ne e kemi menduar një shembull, i cili ka të bëjë me një kërkesë tonën drejtuar Kuvendit të Kosovës. Ne kërkojmë që në secilin fshat të Kosovës, të ketë nga një Shtëpi funksionale të Shëndetit. Arsyeja pse e kemi zgjedhur këtë shembull është sepse të gjithë qytetarët kanë të drejtë të kenë kujdes të mirë shëndetësor.



Vizioni ynë si deputetë të ardhshëm


me anë të votave. Ata janë personat, të cilët duhet të na përfaqësojnë neve denjësisht. Kurse deputetët në Kuvend janë ata të cilët me anë të votave e zgjedhin Kryetarin e Kuvendit, Qeverinë, Presidentin, etj. Në Kuvend janë gjithsej 120 deputetë, të cilët e përfaqësojnë popullin. Ne qytetarët i zgjedhim deputetët në mënyrë që ata t'i përfaqësojnë kërkesat tona në Kuvend. Kuvendi është institucion ligjvënës, sepse deputetët kanë të drejtë të propozojnë ligje, si edhe t'i



Ne, krenaria e shtetit tonë

# QYTETARËT AKTIV ME PUNË DHUROJNË BUZËQESHJE

ELTON (12), ANISA (12), JEHONA (12), DRIJON (11), AMAR (12), FATLUME (11), ARNIS (11)



Këtu kemi paraqitur shkollën tonë dhe disa nxënës duke u kujdesur për ambientin shkollor



Përfaqësuesi i nxënësve e ndau përvojën e tij me shokët e tjerë dhe ata u pajtuan t'i bashkohen atij



Të gjithë së bashku morën iniciativë për të pastruar edhe disa hapësira të tjera të lagjeve të Vushtrrisë

**Qytetaria aktive është një ndër termat më të gjerë që keni dëgjuar ndonjëherë. Artikulli ynë i fton të gjithë lexuesit të lexojnë me vëmendje, sepse do të kenë mundësi ta gjejnë vetveten në pothuajse çdo fjalë të këtij artikulli**

Unë jam qytetar, ashtu siç janë qytetarë edhe 1.8 milion banorë të vendit tim. Nuk ka hapësirë që të mendohet pyetja nëse quhen qytetarë vetëm personat të cilët jetojnë në qytet. Qytetarë janë personat të cilët jetojnë brenda kufijve të një shteti të caktuar, si dhe kanë leje qëndrimi në atë vend. Ndërsa, sa i përket asaj se a është secili prej tyre një qytetar aktiv do ta kuptoni gjatë leximit të artikullit.

Qytetar aktiv mund të jetë çdo njeri. Themi kështu sepse jo të gjithë qytetarëve iu pëlqen të jenë aktiv. Me fjalën *aktiv* iu referohemi atyre personave që gjithmonë sjellin ide dhe marrin iniciativa për të sjell ndryshime pozitive në vendin ku jetojnë. Sipas nesh, primare për të qenë qytetarë aktiv është vullneti i mirë dhe dëshira për të kontribuar për ndryshime pozitive. Në një mënyrë apo në tjetrën, qytetaria aktive ka lidhje të ngushtë me përgjegjësitë që ne si qytetarë i kemi. Këto përgjegjësi vijnë si rrjedhojë e shumë të drejtave që ne i gëzojmë.

Të gjithë qytetarët kanë të drejta të barabarta dhe duhet të trajtohen në atë mënyrë. Kurse, disa nga përgjegjësitë tona janë: respektimi i ligjeve dhe i njëri-tjetrit, mbrojtja dhe pastrimi i ambientit, pagesa e taksave, etj. Qytetarët mund të jenë edhe vullnetarë në mënyrë që të bëhen aktiv. Për shembull, në klasën tonë një

shoqe e jona nuk i kishte kushtet ekonomike shumë të mira. Ne si klasë kemi vendosur që shoqes sonë t'ia blejmë disa gjëra që janë të nevojshme për shkollë, si dhe një çantë shkollore.

Kjo nuk është ndonjë punë shumë e madhe për t'u realizuar. Mirëpo, rëndësia e saj është tejet e madhe. Mjafton që ne si qytetarë t'ia dijmë vlerën dhe rëndësinë e të qenurit qytetarë aktiv.

Ky ishte shembulli ynë, e tash ju të dashur lexues mendoni nëse keni qenë ndonjëherë aktiv dhe cili ishte motivi për ta bërë atë punë. Kënaquni edhe ju me veprat tuaja të mira, ashtu siç u kënaqëm ne sot me punën tonë dhe vullnetin që e kemi për këtë punë.



Qytetarët dhe nxënësit aktiv



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „SHMU 1“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-3  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Vushtrri